


KOPI KYÇYKU

Dy të pagjumë

8JH-1
K 99



Fabula dhe vargje satirike

SH
K 99.

KOPI
KYÇYKU

Dy
të pagjumë



Fabula
dhe
vargje
satirike

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktor

FOTO MALO

Piktor

BARDHYL FICO

Recensues:


Dionis Bubani

Tonin Miloti

HUNDA DHE SYTE

— Më tepër se dy sytë kam rëndësi, —
thosh hunda, që përpjetë gjithnjë rri.
— Gjyslykët përmbi shpinë i mbaj unë,
pa to mërdhijnë sytë në furtunë.





VOZA BOSHE

Dhjetë voza zunë vend
në makinë qetë-qetë,
udhëtuan ec e rend,
njëra veç hidhej përpjetë.

Tundej, shkundej, dam e dum,
sa në krye, sa në qosh,
thoshte: — Unë vlej më shumë,
jo më kot më lanë bosh! —



PO AJO...

U lye plot art gomarica
dhe veshi fustan ngjyra-ngjyra
me vathë, unaza, karfica;
nga pudra i zbardhte fytyra.

— Jam kafsha më e rrallë në botë,
të qartë e kanë anëmbanë.

Pa hidhet një kalë e thotë:


— Veç veshët ndryshuar s'të kanë.



E DREJTA DHE THUMBAT

— Fort mirë që thumbuat arinë,
por tash që la mjaltin në mes,
i flakni tej thumbat, mërinë...
Pa shihni, u bë goxha kthesë!

— O dhelpër, ne thumbat, — tha bleta, —
të gatshëm i mbajmë ngaherë,
pa ta nuk punojmë të qeta,
me ta edhe mjalti s'na shter. —



PAS LUFTE

Kur u sul mbi ujkun qeni me guxim,
çoçëri zu të dridhej, strukur në një ferrë,
dhe, kur ujku ngordhi, doli me nxitim:

— Unë e nxita qenin, — tha, —
më bëni nder!


UJKU DHE FSHATARI

I ndjekur me zjarr nga gjahtari;
vraponte ujkziu me ngut,
t'i lypte strehim një fshatari:
— Të lutem, diku shpejt më fut!

— Jam ngushtë, nuk është punë e lehtë,
por shko te bariu Hajdar,
nuk gjen më të mirë, më të qetë,
i drejtë, siç është çdo fshatar.

— Jo, jo, atje s'shkoj kurrsesi,
se viçin ia hëngra pardje.
— Ahere tek plaku Fazlli,
njeri më mikpritës nuk ke.

E fundja, or ti, mund të shkosh
te Lamja, te bujku Agush...
— Jo, jo, dhe atje kam një borxh!
— Gjej vrimë, s'të dashka askush!






PREZANTIM...

Një ekip, me frymë aksioni,
për kontroll u nis në bazë,
që të kish sukses misioni,
vetë drejtori u shkoi pas.

Kur punëtorët u takuan
me ekipin kokë më kokë,
dhe drejtorit iu drejtuan
— Po ti, nga na vjen, o shok?



NË TERREN

Brigadieri mua në punën prodhuese matës më caktoi në skuadrën time, unë, vetëveprues, emërova dy shkruese, katër ndihmësmatës, tre për rishikime.

Formacion i plotë (ishte ditë e hënë), për të shtunën s'dihej ç'mund të kishte bërë lapsi im si kërraba, po ta kishin lënë, do tërhiqte zvarrë një brigadë të tërë.

NJË TRËNDAFIL

— Lulëzoh si rrallë kush,
rrezëllij nga bukuria,
plot aromë botën mbush,
falë gonxhevë të mia.

— Je i bukur, veç kujdes,
trëndafil, largomu pak, —
foli një zambak me vesë, —
— se me gjemb më nxore gjak!



ANKESA E VJHRRES

— Kur kam qenë nuse, fshati i tërë e di,
si një dele e urtë, vjehrrën egërsirë,
tash që u bëra vjehrrë pyes, jo pa habi:
«Si s'm'u bë nga nuset një siç kam dëshirë?»

KUSHËRIRI I PARË


— Asnjë mi që nuk ka bisht
mbledhja jonë s'do pranojë;
t'i tregojmë dhe me gisht,
gjithë bota t'i dallojë.

Zotësi nuk kanë fare,
bishtin macja ua ka ngrënë,
shkurt: nuk vlejnë as dy pare,
nderi poshtë u ka rënë.

Erdhën minjtë tre nga tre,
një pa bisht u fut në valle.

— Kryemi, pse ndodh kjo, bre?

— Ky s'prish punë: e kam çun halle!



PALLOI DHE DALLËNDYSHJA

Palloi i krekosej dallëndyshes:

— Prej teje, krahëzezë, unë dua
që zogjtë të thonë përditë:


«i mençur, i bukur», si thua?

— Për ty zogjtë flasin dhe shpesh.

— E ç'thonë? Ta di kam dëshirë.

Palloi i tëri u bë vesh:

— Një fyçkë me veshje të mirë!



PASQYRA DHE XHAMI

— Mua ma hap zemrën çdo njeri
dhe gjithçka ia kthej me besnikëri.
Ti, o xham, i ftohtë je, pa ngjyrë, —
xhamin e bezdiste një pasqyrë.

— Bukuri nuk kam, — ia ktheu xhami —
dhe s'më hyn në sy' as buja, as nami;
njerëzve u pres shi, borë e erë,
kur shfryn dimri, brenda ka pranverë.

THËNGJILLI I MBULUAR

Nën cipën e hirit pa jetë
qëndronte thëngjilli i strukur,
ta prekte ndokush, sado lehtë,
qe gati në çast për t'ia skuqur.

Një dorë e shkathët, e shpejtë,
ia flaku tej maskën prej hiri
dhe kokës së tij aq të nxehtë
i bëri një «dush» nga më i miri.



FJALË E RALLË...

Në mbledhjet me shpendët e tjerë
në qoshe veç rrinte guaku
dhe gojën s'e hapte një herë.

— Një mendje më thotë: ky djalë
i heshtur qëndron, — tha rosaku —
se bluan, në sitë shkon çdo fjalë.

— Rosak, mos na fol si në përrallë;
të kishte ç'të thoshte, së paku,
do nxirrte një fjalë më të rrallë...



PAPAGALLI DHE ZOGJTË E PYLLIT

Një papagall në pyll,
(i dukej vetja yll),
gjith' zogjve këngëtarë
u tha: — Qenki të marrë!

E panë me habi.
— Asnjë nga ju, — tha, — s'di
ç'është kënga e melodia,
ç'është nota, fusha e vija...

E zogjtë me shpoti,
iu kthyen: — Këndo ti!
— Jo, — qeshi vesh më vesh.
— Vërtet, ti veç përqesh!



DEBAT

Rosa, pata edhe pula
na u mblodhën kokë më kokë,
lipsej që të vihej vula
për një peshk tre-katër okë.

Dhanë e morën plot tri orë
por vendim nuk nxirrnin dot:
— Fort u lodhëm, qenka zor!
Mbledhja mbyllet, mjaft për sot.

Dita tjetër erdh e nxehtë;
kur u çel mbledhja sërish
s'pat debate, rrodhi qetë,
se dhe peshku krejt u prish.



MJAU-MJAU...

Po qahej një mace te shoqja e vet:

— Ka kohë, një mi s'po më bie ndër dhëmbë...

— Ti motër, — tha tjetra, — ke veç një të
metë:

me mjaut e shumta që larg gjahun tremb.

ME RRUAT DHE... TË RRUAT!

Kur zogj të bukur i bënte pula,
shpejt «të më rojnë!» thoshte këndesi;
kur ndonjë syresh kish pulla e vula,
i thosh «të rruat ty dhe qymezit!»



S'JAM ME AI

Këndesi lafshëgjatë e kishte për zemër
të shprehej: — I madh në u bëfsha njëherë,
do sillem fort mirë, do bëj vërtet emër;
o gjela, prej meje do shihni veç nder!

Mjafton që rojtarit te Pllaja e Burimit
t'i thoni: Lafshëgjatin, ne jemi ata!
dhe fill do të zbres mu tek vendi i takimit,
në qafë t'ju hidhem, t'ju bëj temena.

Dhe shkallët i ngjiti pa shkuar as viti,
pa bëri dhe emër goxha ky lafshëgjatë.
Kur vajtën këndesët, i qeshur i priti,
të falat që mori, i nisi në fshat.

I erdhën të tjerë (kaluan ca muaj):
— Ata jemi, — thanë — dhe kemi një punë.
— Vërtet, më kujtohet i gjithë soji juaj,
ama po habitem: më ç'doni nga unë?!

Kaluan pak ditë dhe ja, lafshëgjati
si pulë e lagur çapitej ngadalë,
një zë, tek e pa diku monopatit,
i tha: — Pse harrove, o gjel, nga ke dalë?

PËLHURA E MERIMANGES


U fut një merimangë në dyqan
dhe pa që njerëzit blenin plot pëlhurë,
— Do shes dhe unë pëlhurë anembanë,
sa unë njerëzit s'thurrin bukur kurrë.

E endi shpejt modelin dhe e vari
ta shihte klientela me zili;
një grua që kaloi andejpari
në kosh me fshesë e hodhi, sa çudi!

— Aspak mos u habit, —i tha një bletë,
nuk çmohet vetëm forma në pëlhurë,
pëlqehet po pat vlerë të vërtetë
edhe qëllim fisnik kur nis e thur.

NJË MESAZH NGA PESHKU

Fort m'u dhimbs në det një rrjetë,
që, tek lutej, derdhte lot:
— Peshk, tek unë futu vetë,
se gjahtari s'të zë dot!



UJKU DHE KËLYSHI

— Kam gjetur, — tha ujkthi, — për drekë
një pre,
një tufë me shqerra kullosin në va.
— Bariu si dukej? Për të gjë s'më the,
se veç me njeriun nuk bëhet shaka.

— Bariu, dëgjova, na qenka sypishë,
por qentë, me ç'pashë, nuk ishin njësoj;
të çajmë ca qengja pa frikë, a do vish?
Mes qenve do gjejmë një shteg... — ujkthi
shtoi.



— As kaq nuk lëvizim, dëgjo ti këtu:
s'mban qen të hutuar bariu me mend,
në s' duam të hamë një dru e çfarë dru,
oburra, nuhatni mos ka tjetër vend!

KAZOJA DHE BALOJA

Tek çante me qetë ugarë,
veç Kazon qëllonte pendari.
Kur vapa shtrëngoi në arë,
kaloi një bujk andej pari.


— Çuditem, — i tha, — ç'ke me Kazon,
ai po lëron shpejt e mirë,
nga brazda më fort shmanget Balua,
atë fshikullo pa mëshirë.

— Më duket nxitohesh kur flet, —
ia ktheu gjakftohtë pendari,
— nga brazda del Balua vërtet,
por ters e nxit Kazo gërnjari...



SAKTËSIM

U vrenjt një dembel kur i thanë: «gomar»;
nga kjo u sëndis një gomar i vërtetë
e palli: — Kafshatën me djersë e marr,
nuk jam parazit, si ky tip mendjelehtë!



KËNDESI DHE ROSA

Tallte në mëngjes
rosën një këndes:
—Ç'racë, sa bezdi,
as të ecë s'di!

Rosa ga-ga-ga,
ja ç'përgjigje dha:
— Eja të notojmë,
në ujë të bisedojmë!

«E U R E K A»

Kur mëngët i nxori të shkurtra sa s'ka,
me zell mjeshtëror preu copa nga fundi;
i qepi tek mëngët buzëqeshi e tha:

— Vërtet mendjen vrava, por më kot s'më
shkoi mundi!



QERRJA ME QYPA

Një qerre ngarkuar me qypa
tërhiqnin dy qe mengadalë,
nga larg, sa e panë dy viça,
u tallën me gjeste dhe fjalë.

«I çojmë ne qypat si erë,»
i morën dhe nganë me vrap,
harruan përvojën e qerres,
i thyen sa hodhën një hap.



BASHKËSHORTI MENDJEMPREHTË

Greri me një thumb të gjatë
punën hiç s'e kish nën thua.
Por s'e hante bukën thatë:
milingonën zgjodhi grua.

DELJA DHE BUALLICA

— Si s'e paske fshirë hiç këmbën e majtë! —
deles buallica i tha ftohtë e prerë.

— Ti në mes të llucës zhgërryesh ditë e natë
e s'të qesëndisa qoftë edhe një herë!



TË PAKTËN NJË HERË...

— Jam i zoti, jam i zgjuar, —
mburrej bufi or' e çast.

— Mirë, buf, por do provuar
kjo, të paktën, në një rast!



N Ë M!

Një kec ra prej urës në lumë
dhe ndihmë kërkoi me nxitim;
një cja, që «nëm!» thosh dhe në gjumë,
— Nëm këmbën, në daç, — tha, — shpëtim!

SERVIL GUXIMTAR


Të tëra format i konsumoi,
por, që t'i hynte në shpirt më shumë,
guxoi drejtorit ndihmë i kërkoi:
— Ç'shërbim kërkoni më shumë nga unë?



MIKU I VËRTETE

Keci̇ zu t'i thosh qengjit një ditë:

- Kë mjaft kohë pa më ardhur për vizitë.
- Qofsh shëndoshë ti, pa nuk prish punë,
hall në paç, më thirr: në çast vij unë.



SYZET E KRITIZERIT

I sjell mërzitje
çdo libër i ri,
qëmton «lajthitje»
me rëndësi.

— Duhet riparë
në tërësi,
pastaj i tëri
në thellësi.

Dhe vise-vise
do fort kujdes,
konflikti ndizet,
por... me vonesë!

Gjë pozitive
në asnjë anë,
(ia kanë fajin
syzet që mban).

SEKRET PROFESIONAL


— A mund të më thuash, shoku kamerier, vallë, si na bëkan tre plus katër nëntë?

— Është sekret profesional, o byrazer, më fal, jam në detyrë, më ikin «dhentë»...



NE NJE GARE

Kur në finish lepuri mbërriti,
derri sa hodhi hapin e parë,
porse arbitri vendimin qiti:
— Hallall i qoftë derrit kjo garë!



DY ANËT E GJUHES

Kur i thanë strucit: — Na këndo!
— Jam gamile, — tha, (kaq pati hall);
kur i thanë: — Mallrat transporto!
Shpejt u hodh: — Jam zog, nuk jam hamall.

AMATORI I VATHEVE


(Një hakmarrësi)

Sa kohë ish Nevruzi shef,
lloj-lloj vathë mblidhte me qejf:
të mëdhenj sa një patkua
dhe të vegjël sa një thua.
Sa her' vinte vath të ri,
pamje tjetër kish ai:
qiell dimri në fytyrë,
gjithsaher' vinin në zyrë
«të pabindur», kritikues...
(ai desh vetëm dëgjues...)
Veç një ditë atë veshë,
u këputën, s'mbajtën peshë...

N J Ë D R A M A T U R G U

Nga dhimbjet e lindjes një mal
buçiti tri net e tri ditë;
e dimë, ç'ta zgjatim me fjalë:
një mi nxori mali në dritë.

Kjo bëmë më solli ndër mend
premtimet e burrit me kokë:
— Një epos në vargje po end! —
dhe polli tri vargje ulokë!



«ORIGJINALITET...»

(një fabulbërësi)

E di fare mirë që rrjedh nga majmuni,
ama imitimin s'e kam hiç në gjak
dhe sa për një fabul që ngjan nga Haruni,
besoni: në mendje s'e pata aspak.

Kur timen e stisa me shije të lartë,
gjith' kafshët i shkova në shoshë e në sitë,
ariun në derr e shndërrova me art,
ndryshon dhe kasollja, më plaçin dy sytë!

BILBILI DHE PYLLI

Bilbilit, kur e mbyllën në kuvli,
i thanë: — Tÿ asgjë s'do të të mungojë!
I vunë dhe një bisk për shoqëri.

— Për pyllin, — tha, — për pyllin kam
nevojë!



GALLOFI DHE BLETA

Gallofi zu vend mbi një mollë
dhe bletës, tek thithte nektar,
i tha: — Si s'je ca mendjehollë,
po djersën e derdh si ujëvarë?

Me ty janë mijëra të tjera,
ndaj puna s'të dihet aspak,
un' krahët veç rrah kur fryn era
dhe zogjtë ndiejn' frikë sa bëj «krrak».

— E lumtur gjithmonë, — tha bleta, —
me shoqet punoj pa përtim,
mes tyre kuptim marrka jeta,
në tog më shijon mjalti im.


II Në vathën e tyre

PA ZHURMË

Prej ujkut qengjat s'kishin më pasoja
(barinjtë morën masat pa vonesë);
çakalli, që ende s'i kish dale boja,
zanatin e vazhdonte në «harresë»...

PAPUNËSIA

Bukë s'ka
as strehë,
as dritë,
por, çudi,
shtati i saj
rritet përditë!



PA DHËMBË E ME «DHËMBË»

Shkoi të vinte dhëmbët një punëtor,
por, sa pa çmimin, tha me tmerr:—

Heq dorë,
se vërtet pa dhëmbë nuk ngrënke dot,
por, dhe në i vënça, s'kam ç'ha qysh sot.



KUR QELBET EDHE KRIPA

Çakalli u rrëzua
nga qitësi syfajkua.

Dhe kërmës menjëherë
i mori trupi erë.

Ndaj ujku mendjeokë
i hodhi kripë në kokë.

I hodhi, por ç'e do:
më keq u qelb ngado.

Kur kripa marrka erë
«ilaçi» i saj s'ka vlerë.

DIALOG

— Qenka shembur një minierë,
vdiqën qindra minatorë.

— S'na the gjë, sot një bankier
ra nga skitë, ndrydhi një dorë.

LOTËT E ÇAKALLIT

Kur pa çakalli gë u shkël një mīlīngonë,
filloi t'i derdhë lotët çurg e lumë.

— Kjo pamje e trondit krejt fisin tonë,
besomëni se sonte s'do kem gjumë.

Qysh sot do të ndryshojmë, si në përrallë,
me shpendët do t'ia çojmë mrekullī;

ç'ta zgjatim: zogj, tani do bëni pallë.

— Vërtet?! Na ngjan çudi përmbi çudi!

— Kësaj i them unë zemër, — shtoi një pulë,
shikoni çfarë çakall me shpirt e mend!

Por, nata sapo ra, çakalli u sul
e brenda në kotec nuk la një shpend.

SKIFTERI DHE PULAT

Ndër leqe skifteri pa veten,
bri zogjve të pulës një herë;
— Këtu do mbaroj e do mbetem,
se krahët tani më janë prerë...

Të dilja një ditë nga leqet,
do shkrepja porsì meteor,
sa herë që dhelpra shpirtkeqe
të qasej tek ju, zogj të gjorë.

Përlotur dhe syperënduar
ngjasonte jo pak si i mjerë,
gjersa disa zogj pendëshkruar
u bënë për të zemërgjerë.

... Liruar u sul porsì bisha.
— Skifter, pse na preve në besë?
— Premtimin e bëra kur isha
me halkë në fyt e pa shpresë.

NJË FTESE

— Ju ftoj të hiqni dorë
nga gjithë prapësitë,
përndryshe, mor të gjorë,
pendoheni një ditë.

Ç'fjalim në ato, zabele
mban ujku këtë herë!
Veç qyrkun prej lesh dele
nuk tha ku e pat prerë.



DY TË PAGJUMË

Qengji i vogël nuk ka gjumë
se një shok lëndoi me fjalë;
edhe ujku vuan shumë
se s'dëmtoi kopenë në mal.

P E R M B A J T J A

I

Hunda dhe sytë	3
Vazo boshe	4
Po ajo... ..	5
E drejta dhe thumbat	6
Pas lufte	7
Ujku dhe fshatari	8
Prezantim... ..	10
Në terren	11
Një trëndafil	12
Ankesa e vjehrrës	13
Kushëriri i parë	14
Palloi dhe dallëndyshja	15
Pasqyra dhe xhami	16
Thëngjilli i mbuluar	17
Fjalë e rrallë... ..	18
Papagalli dhe zogjtë e pyllit	19
Debat	20

Mjau-mjau...	21
Më rruat dhe... të rruat!	22
S'jam më ai	23
Pëlhura e merimangës	25
Një mesazh nga peshku	26
Ujku dhe këlyshi	27
Kazoja dhe Baloja	29
Saktësim...	30
Këndesi dhe rosa	31
«Eureka»	32
Qerrja dhe qypa	33
Bashkëshorti mendjemprehtë	34
Delja dhe buallica	35
Të paktën një herë...	36
Nëm!	37
Shërvili guximtar	38
Miku i vërtetë	39
Syzet e kritizerit	40
Sekret personal	42
Në një garë	43
Dy anët e gjuhës	44
Amatori i vathëve	45
Një dramaturgu	46
«Origjinalitet»	47
Bilbili dhe pylli	48
Gallofi dhe bleta	49

II

Në vathën e tyre	50
Pa zhurmë	50
Papunësia	51
Pa dhëmbë e me «dhëmbë»	52
Kur qelbet edhe kripa	53
Dialog	54
Lotët e çakallit	55
Skifteri dhe pulat	56
Një ftesë	57
Dy të pagjumë	58

891.983-191

+ 891.983-7

(B.v.) 891.983-1

+ 891.983-7

K 99

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re

Tiranë, 1987